



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.96/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Adnan Konushevci dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Vlerona Maliqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova me seli në Prishtinë, paraqitur kundër koalicionit Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Partia Socialdemokrate (AAK&PSD), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterëve të kandidatëve të tyre në afërsi të objekteve publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 27.09.2019, mori këtë:

### VE N D I M

**Refuzohet** e pabazuar ankesa Anr.96/2019 e datës 26.09.2019, e paraqitur nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, kundër koalicionit Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Partia Socialdemokrate (AAK&PSD), me seli në Prishtinë.

### A r s y e t i m

Më datë 26.09.2019, Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, ka paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se më datë 26 Shtator 2019 në orën 14:00, në afërsi të objekteve publike, konkretisht përballë Fakultetit të Edukimit, Fakultetit të Muzikës, Akademisë së Shkencave dhe Ministrisë së Arsimit, janë parë një numër i madh i posterëve të cilët janë vendosur nga ana e koalicionit AAK&PSD, e të cilët posterë i takojnë kandidatëve për deputet të këtij koalicioni, respektivisht bëhet fjalë për posterët e Shpend Ahmeti-t, Dardan Sejdiu-t, Driton Qausht-t dhe të tjerëve. Me këtë paraqitësi i ankesës ka pretenduar se ky veprim i koalicionit AAK&PSD është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, respektivisht nenin 33 të këtij ligji, poashtu ka shtuar se ky veprim paraqet shkelje të Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013 – “Fushata e Zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike”, neni 3 pika 4, si dhe Kodit të Mirësjelljes nenit 4 pika B.

Paraqitësi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë, si dëshmi ka bashkangjitur fotografi të posterëve të kandidatëve për deputetë të koalicionit AAK&PSD.

Në përgjigjen në ankesë të datës 27.09.2019, koalicioni AAK&PSD, thekson se pretendimet ankimore të paraqitura në ankesën Anr.96/2019, të datës 26.09.2019, nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, janë të pabazuara dhe nuk gjejnë mbështetje në

ligj apo në ndonjë rregullore e cila ka të bëjë me shkeljet e procesit zgjedhor. Sipas të njëjtit hapësirat ku janë vendosur posterët e kandidatëve për deputetë nga radhët e koalicionit AAK&PSD, janë hapësira reklamuese në shfrytëzim të Kompanisë “Selmans Network SHPK”, në bazë të kontratës me Drejtorinë për Shërbime Publike të Komunës së Prishtinës, e me të cilën kompani koalicioni AAK&PSD ka lidhë marrëveshje me shkrim për vendosje dhe reklamim në hapësirat reklamuese. Më tej ka shtuar se koalicioni AAK&PSD, është i vetëdijshëm për respektimin e bazës rregullative mbi të cilën është bërë ankesa respektivisht Rregullën Zgjedhore Nr.13/2013, atë Nr.11/2013, Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët. Në fund ka kërkuar që PZAP-i ankesën e paraqitur nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova ta hudhë poshtë si të pabazuar.

Paraqitësi i përgjigjes në ankesë në mbështetje të pretendimeve të tij, si dëshmi ka bashkangjitur disa njoftime që koalicioni AAK&PSD, ka bërë në rrjete sociale për anëtarët dhe simpatizantët e tij, lidhur me respektimin e rregullave zgjedhore për fushatën elektorale për zgjedhjet e 6 tetorit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

#### **Ankesa është e pabazuar,**

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga ana e koalicionit AAK&PSD, nuk është bërë shkelje e nenit 33 pika (b) të LZP-së, pasi që posterët lëndor të kandidatëve për deputet nga koalicioni AAK&PSD, janë vendosur në vendin e dedikuar për reklamim - vendosje të posterëve.

Paneli erdhi në përfundim se janë të paqëndrueshme pretendimet e paraqitësit të ankesës se këto veprime përbëjnë shkelje të Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, dhe shkelje të Kodit të Mirësjelljes nga koalicioni AAK&PSD, pasi që posterët në fjalë janë të vendosur në vendin e dedikuar për vendosjen e tyre, ashtu siç vërtetohet edhe nga fotografitë e bashkangjitura ankesës nga pala ankuese që gjenden në shkresat e lëndës.

Nga arsyet e theksuar më lartë, e duke u bazuar në nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa**

Anr.96/2019 më datë 27.09.2019

**Kryesuesi i Panelit**

Fejzullah Rexhep



***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.